

Novobërdë 17 maj 2012 - 17 maj 2012



U nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi për projektin “Ndërtimi i trotuarit nëpër vendbanimin Llabjan përgjatë rrugës Novobërdë”

Kryetari i Komunës së Novobërdës z.Bajrush Ymeri së bashku me z.Dardan Maliqin zyrtar i projekteve pran LOGOS-it Zvicëran nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për projektin “Ndërtimi i trotuarit nëpër vendbanimin Llabjan përgjatë rrugës Novobërdë”.

Ky projekt ka për qëllim të përmisojë vështirësitë e banorëve në kalimin e rrugës lokale ku ata zakonisht e kalojnë këtë rrugë me vështirësi, elementi tjetër i rëndësishëm është se edhe nxënësit e kësaj zone kanë vështirësi për vajtje-ardhje në shkollat e tyre.

Ky trotuar do të ju mundësojë të gjithë banorëve qasje me të lehtë dhe më të shpejtë në shërbimet shëndetësore, arsimore etj.